



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 dhjetor 2017

Nr. ref.: RK1158/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI59/17

Parashtrues

Mejdi Zymberi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. 29/2016, të 27 dhjetorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Mejdi Zymberi në emër të NTN “Mega Engineering”, me seli në Gjilan, të cilën e përfaqëson Ardi Shita, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 29/2016, të 27 dhjetorit 2017, të cilin e ka pranuar më 25 janar 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesit pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 maj 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 26 maj 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 2 qershor 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 18 tetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Sa i përket procedurës kontestimore

9. Më 19 gusht 2002, parashtruesi paditi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Ekonomike) Ndërmarrjen "Hidroteknika" nga Gjilani në cilësi të kontraktuesit dhe Kryqin e Kuq Ndërkombëtar (në tekstin e mëtejme: KKN) në cilësi të donatorit për pagesën e një shume të hollash (22.903 euro) të mbetura borxh, në emër të punëve shtesë të kryera nga parashtruesi, e që tejkalonin punët e parapara ndërtimore me kontratën bazë të lidhur në mes të parashtruesit dhe palëve të paditura.
10. Më 27 shtator 2002, Gjykata Ekonomike e Qarkut (Aktvendimi VII C. nr. 147/2002) vendosi ta hedhë poshtë padinë për shkak të mungesës së interesit

- juridik, duke konstatuar se parashtruesi kishte mundur të ushtronte drejtpërsëdrejti kërkesë për lejimin e ekzekutimit të borxhit.
11. Më 14 tetor 2002, parashtruesi paraqiti në Gjykatën Ekonomike, propozim për lejimin e ekzekutimit të borxhit të pretenduar ndaj të paditurve.
 12. Më 17 tetor 2002, (Aktvendimi nr. 103/02) Gjykata lejoi përmbarimin e kërkuar.
 13. Në një datë të paspecifikuar, i padituri i parë ndërmarrja "Hidroteknika" paraqiti kundërshtim ndaj aktvendimit për lejimin e përmbarimit.
 14. Më 4 mars 2003, Gjykata Ekonomike, duke vendosur lidhur me kundërshtimin (Aktvendimi VCL. nr. 210 /2002), e shpalli veten jokompetente për vendosje të kësaj çështje juridike, duke vendosur gjithashtu, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi shkresat e lëndës t'i dërgohen Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme si Gjykatë kompetente. Ky aktvendim sipas këshillës juridike mund të apelohej në Gjykatën Supreme të Kosovës.
 15. Më 19 qershor 2003, Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të ankesës së parashtruesit me Aktvendimin Ae. nr. 34 /2003, vendosi që në pjesën që ka të bëjë me të paditurin e parë ("Hidroteknika") ankesën ta refuzojë, ndërsa në pjesën që ka të bëjë me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar padinë ta pranojë, duke prishur Aktvendimin e Gjykatës Ekonomike VCL. 210/2002 në atë pjesë, dhe në vazhdim të procedurës çështjen juridike e ktheu në rigjykim në Gjykatën Ekonomike.
 16. Më 28 tetor 2008, me Aktgjykimin II. C. nr. 196/2008, Gjykata Ekonomike në procedurën e ripërsëritur sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme, ka anuluar aktvendimin mbi lejimin përmbarimit E. nr. 103/02, të 17 tetorit 2002, dhe në tërësi ka refuzuar padinë e parashtruesit lidhur me pagesën e borxhit të pretenduar.
 17. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimin të Gjykatës Ekonomike të cekur si më sipër.
 18. Më 2 maj 2012, Gjykata Supreme (Aktvendimi Ac. nr. 91/2009) vendosi të *"Pranohet si e bazuar ankesa e paditëses dhe të prishet Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë II.C.nr.196/2008 datë 28.10.2008 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim"*.
 19. Më 20 shtator 2012, Gjykata Ekonomike e Qarkut (Aktgjykimi nr. 224/2012), në procedurën e ripërsëritur e të zhvilluar sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme, vendosi që të aprovojë kërkesëpadinë e parashtruesit lidhur me të paditurin "KKN", ndërsa për të paditurën "Hidroteknika" ta refuzojë.
 20. Në një datë të pacaktuar, KKN paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktgjykimin të Gjykatës Ekonomike të Qarkut III. c. nr. 224 /20012 , për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit

të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

21. Më 1 mars 2016, (Aktgjykimi Ac. nr. 14/2013) Gjykata e Apelit e Kosovës, refuzoi si të pabazuar ankesën e të paditurit "KKN", ndërsa e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut III. C. nr. 224/2012, të 20 shatorit 2009.
22. Më 27 dhjetor 2016, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës për revizion të paraqitur nga e paditura KKN, vendosi që të pranojë si të bazuar revizionin (Aktgjykimi E. Rev. nr. 29/2016), ashtu që në tërësi refuzoi padinë e parashtruesit lidhur me kërkesën, për të detyruar KKN, që t'ia paguaj borxhin e pretenduar. Gjykata Supreme gjeti se Kryqi i Kuq Ndërkombëtar nuk kishte legjitimitet pasiv për të qenë palë e paditur në këtë kontest.

Procedura përmbarimore ndaj KKN-së

23. Pasi që Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac. nr. 14/2013 u bë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm e me të cilin ishte obliguar KKN që parashtruesit t'ia paguaj borxhin e cekur si në padi, parashtruesi me një datë të paspecifikuar, paraqiti propozim për ekzekutim tek Përmbaruesi privat me qëllim të arkëtimit të atij borxhi.
24. Më 17 maj 2016, përmbaruesi privat E. M, nxori urdhrin P. nr. 129/16 për lejimin e përmbarimit.
25. Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit privat si më sipër, KKN në afat ligjor kishte ushtruar prapësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, *inter alia*, duke theksuar se ky institucion ka imunitet ndërkombëtar dhe nuk mund të jetë palë e paditur.
26. Më 14 dhjetor 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi PPP. nr. 454/16) refuzoi prapësimin e parashtruar nga KKN.
27. Më 19 janar 2017, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, KKN parashtroj ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, duke pretenduar se Kryqi i Kuq Ndërkombëtar gëzon imunitet bazuar në një memorandum të nënshkruar me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në bazë të këtij imuniteti lirohet nga përgjegjësia civile në lidhje me borxhet dhe dëmet.
28. Sipas dokumentacionit të bashkëngjitur me kërkesën nga parashtruesi, rezulton se kjo procedurë në Gjykatën e Apelit akoma nuk ka përfunduar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 29/2016, i 27 dhjetorit 2017 lidhur me kërkesën për revizion ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse ka pasur elemente të kontradiktoritetit në raport me vendimet paraprake gjyqësore, dhe për pasojë vendimi gjyqësor është arbitrar, ndërsa është cenuar edhe drejta për vendim të

arsyetuar gjyqësor si komponentë të pandashëm, të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së.

Pranueshmëria e kërkesës

a) Sa i përket pjesës që ka të bëjë me procedurën kontestimore

30. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 7 i Kushtetutës, i cili parasheh:
- “7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
32. Më tej, Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:
- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*
33. Në fund, Gjykata i referohet edhe rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:
- (1) *“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar,
[...] dhe*
- “(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose”.*
34. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit i përmbush kriteret e nenit 113.7 sa i përket palës së autorizuar dhe është parashtruar brenda afateve të nenit 49 të Ligjit, ndërsa një pjesë e saj nuk e plotëson kushtin e shterjes së mjeteve juridike.
35. Gjykata vëren se parashtruesi ka pretenduar në mënyrë specifike se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 29/2016, të 27 dhjetorit 2016, i është shkelur e drejta kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm [neni 31 i Kushtetutës] dhe të drejtën për një proces të rregullt [neni 6 i KEDNJ-së], të cilat kanë përmbajtjen si në vijim:

Neni 31 i Kushtetutës [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

Neni 6 i KEDNJ-së [E drejta për një proces të rregullt]

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e Gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

[...]

36. Gjykata gjen se argumentet e parashtruesit lidhur me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm konsistojnë në pretendimin e parashtruesit lidhur me nxjerrjen e vendimeve kontradiktore në gjykata të instancave të ndryshme gjyqësore, duke theksuar se vendimet e tilla kanë cenuar garancitë e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, që kanë të bëjnë me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor dhe vendim gjyqësor jo arbitrar.
37. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata vlerëson nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës (shih, *inter alia*, *mutatis mutandis*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 16 dhjetor 1992, f. 34, seria A. nr. 247, dhe *B. Vidal kundër Belgjikës*, 22 prill 1992, f. 33, seria A. nr. 235).
38. Gjykata konstaton se ashtu sikur theksohet në paragrafët 5-17 të raportit, se ndërmjet periudhës kohore 2002 - 2016 në Gjykatën Ekonomike të Qarkut dhe në Gjykatën Supreme janë zhvilluar një varg procedurash gjyqësore dhe janë nxjerrë vendime me përfundime të ndryshme me të cilat parashtruesit i aprovohej padia, e pastaj në procedurën ankimore çështja kthehej në rigjykim në shkallën e parë vendimmarrëse.

39. Përfundimisht, çështja juridike sa i përket procedurës kontestimore ka marrë zgjedhjen e saj juridike me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 29/2016, të 27 dhjetorit 2016, në të cilin në mes tjerash, Gjykata Supreme ka arsyetuar për pjesën që ka të bëjë me të paditurin e parë dhe lidhur me faktin nëse parashtruesi ka të drejtën në kompensimin e kërkuar monetar. *“Për punët shtesë nuk është lidhur aneks kontrata as marrëveshja me të cilin palët kontraktuese do të caktonin drejta dhe detyrime, e cila do të konsideroj se ka cilësinë e ofertës për kryerjen e punëve shtesë. Punët shtesë, pa marrëveshje me porositësin e punëve nuk ka bazë ligjore për kompensim.”*
40. Gjykata Supreme, më tej, ka theksuar se *“Në bazë të dispozitës së nenit 630 par. 2 të LMD-së, te kontrata e ndërtimit kërkohet forma me shkrim e kontratës dhe se një formë e tillë kërkohet edhe për ndryshimet-aneksat e kontratës dhe për ndryshimet e mëvonshme pa formën e caktuar nuk ka efekt të vlefshëm juridik”.*
41. Ndërsa, sa i përket pjesës së padisë lidhur me të paditurin e dytë “KKN”, Gjykata Supreme në arsyetimin e aktgjykimit të revizionit ka theksuar *“E paditura e dytë Kryqi i Kuq Ndërkombëtar në rastin konkret nuk ka legjitimitet pasiv që në këtë çështje juridike, për arsye se e paditura e dytë nuk ka qenë në raport materialo-juridik me paditësin pasi që të njëjtit nuk kanë qenë në raporte kontraktuese e kjo vërtetohet edhe nga kontrata që është lidhur në mes të paditësit dhe të paditurit të parë të cilët figurojnë si palë kontraktuese, ndërsa e paditura e dytë ka qenë donator i punimeve të kryera dhe nuk ka pasur as një detyrim nga kontrata mbi ndërtimet e që shihet edhe nga vet përmbajtja e kontratës në fjalë.”*
42. Lidhur me si më sipër, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, par. 28. Shih gjithashtu rastin nr. 70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
43. Gjykata mundet vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë, sa që procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
44. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 29/2016, si dhe aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta kishin ofruar përshkrim të gjerë dhe të plotë të fakteve të rastit dhe kishin dhënë arsye të shumta për gjetjet e tyre ligjore në përgjigjen ndaj pretendimeve të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës. Prandaj, Gjykata konstaton se procedurat e ndjekura lidhur me rastin në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara në mënyrë të mjaftueshme. (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

45. Gjykata vëren se parashtruesi ka pasur mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e vet në Gjykatën Ekonomike, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, duke përdorur mjetet e ankimit, ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore; andaj, procesi në tërësinë e tij nuk mund të cilësohet si arbitrar apo i padrejtë.
46. Gjykata, duke u mbështetur në praktikën e vet gjyqësore rikujton se në rrethana identike në rastin KI53/14, i cili gjithashtu kishte për objekt një procedurë për kompensimin monetar për punët shtesë, kishte shpallur kërkesën të papranueshme; andaj, në rastin konkret nuk gjen arsye të shmangies nga praktika e vet gjyqësore (shih rastin KI53/14 të parashtruesit NTP "LLabjani" të 7 korrikut 2014, të Gjykatës Kushtetuese).
47. Për më tepër, Gjykata vlerëson se rasti i saj KI72/14, i potencuar nga parashtruesi nuk mund të jetë i aplikueshëm edhe në këtë rast. Në një rast të tillë, Gjykata Kushtetuese konstatoi shkelje të të drejtave të parashtruesit të kërkesës, sepse Gjykata Supreme nuk dha përgjigje të qarta dhe të plota *vis-a-vis* parashtrësive vendimtare pronësore të parashtruesit të kërkesës. Kjo, nga ana tjetër, rezultoi në shkelje të së drejtës së parashtruesit për t'u dëgjuar dhe të së drejtës së tij për një vendim të arsyetuar që rrjedhin nga garancitë e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
48. Gjykata vëren se kjo kërkesë ka të bëjë me kompensimin e një kërkesë monetare, e cila si e tillë nuk është miratuar apo vërtetuar me vendimet e gjykatave të rregullta.
49. Si përfundim, Gjykata konkludon se sa i përket pjesës së parë, kërkesa në baza kushtetuese nuk është arsyetuar *prima facie* dhe se faktet e paraqitura në kërkesë nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkelje të një të drejte kushtetuese; andaj, në përputhje me rregullin 36 (2) a) dhe b) kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar.

b) Sa i përket procedurës përmbartimore

50. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 14/2013, i 1 marsit 2016 ka qenë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, andaj në procedurë përmbartimore përmbartuesi privat E. M. ka lejuar përmbartimin e tij dhe, gjithashtu, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP. nr. 454/16 ka refuzuar prapësimin e të paditurës KKN.
51. Gjykata vëren se pas Aktvendimit të Gjykatës Themelore KKN ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit dhe kjo procedurë akoma nuk ka përfunduar.
52. Në rrethanat kur nuk ka një vendim përfundimtar në procedurën përmbartimore, kërkesa e parashtruesit për këtë pjesë është e parakohshme dhe, rrjedhimisht, e papranueshme (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI151/13 të parashtrueses *Sitkije Morina*, të 23 dhjetorit 2013).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 49 të Ligjit dhe rregullat 29 dhe 36 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 18 tetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi